



Governor Chris Christie
State of New Jersey



Governor Andrew M. Cuomo
State of New York

DEKLARATE E PERBASHKET NGA GUVERNATORET KUOMO (CUOMO) DHE KRISTI (CHRISTIE) MBI MOSMIRATIMIN NGA KONGRESI TE PAKETES SE NDIHMES PER URAGANIN SENDI (SANDY)

“Me gjithshka që ka përjetuar dhe duruar Nju Jorku (New York) dhe Nju Xhërsi (New Jersey) dhe miliona banorë dhe biznese të vogla tonat, kjo mungesë e vazhdueshme veprimi dhe indiferencë nga Dhoma e Përfaqësuesve është e pajustificueshme. Tani janë bërë 66 ditë që kur goditi Uragani Sendi (Sandy) dhe 27 ditë që kur Presidenti Obama paraqiti një propozim të përgjegjshëm të ndihmës, i cili u miratua në një votim nga të dyja partitë në Senat, ndërsa Dhoma e Përfaqësuesve nuk ka arritur as t’ a vendosë atë për diskutim. Ky dështim për të ardhur në ndihmë të amerikanëve pas një katastrofe natyrore të rëndë dhe shkatërruese është pa precedent. Fakti se ditët vazhdojnë të kalojnë ndërsa njerëzit vuajnë, familjet janë jashtë shtëpive të tyre dhe burrat e gratë mbeten pa punë dhe përipiqen gjatë këtyre muajve të ashpër të dimrit është një moskryerje e detyrës. Kur shtetasit amerikanë kanë nevojë, u vijmë në ndihmë. Ajo traditë u braktis në Dhomën e Përfaqësuesve natën e kaluar.”

“Njerëzit e shteteve tona nuk mund të përballojnë më që të presin ndërsa politikanët në Uashington (Washington) bëjnë lojra.”

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418